




KRU "Hidroregjioni jugor" Sh.A. me seli në Prizren



Në bazë të neninit 7.pika 2. Statutit të KRU "Hidroregjioni jugor" Sh.A., me datë 01.10.2010, Bordi të Drejtorëve KRU "Hidroregjioni jugor" Sh.A. me seli në Prizren, aprovoi këtë :

Rregullore për përdorimin e automjetëve të KRU "Hidroregjioni jugor" SH.A. në Prizren

Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin e përdorimit të rregullt dhe racional të automjetëve që janë në pronësi të KRU "Hidroregjioni jugor" Sh.A. Prizren.

Neni 1

Automjetet (vetura, kombi, kamion, cistern, etj) e KRU "Hidroregjioni jugor" Sh.A. janë automjete zyrtare dhe si të tilla janë në pronësi të saj, të cilat mund të përdoren vetëm për qëllime zyrtare (kryerjes së punëve dhe detyrave të punës) në kuadër të KRU "Hidroregjioni jugor" Sh.A. Prizren.

Neni 2

Kategoritë e zyrtarëve të KRU "Hidroregjioni jugor" Sh.A. Prizren që kanë të drejtë të përdorin automjetin

- Kryeshefi Ekzekutiv i cili ka shoferin e përhershëm,
- Zyrtarët lartë të Kompanisë, mund të përdorin automjetet zyrtare të KRU "Hidroregjioni jugor" për të kryer punët zyrtare.
- Punëtorët tjerë që nuk radhitën në kategoritë e lartë shënuara mund të përdorin automjetet e KRU "Hidroregjioni jugor" Sh.A. Prizren me leje të veçantë të nënshkruar nga eprori i tij dhe të miratuar më pas nga shefi i shërbimit të automekanismit.

Neni 3

- Shoferët, të cilët kryejnë detyrat e punës (kanë përkrahimin e punëve) si shofer profesional të automjetëve në Kompani, drejtojnë automjetet e KRU "Hidroregjioni jugor" Sh.A. Prizren si detyrë të punës.

Neni 4

Përveq logos së KRU "Hidroregjioni jugor" Sh.A. Prizren dhe reklamave të Kompanisë, automjetet nuk mund të kenë kurrfarë shenjë tjetër të ngjitur në të.

Neni 5

Te gjithë përsoneat që përdorin automjetet zyrtare duhet që me rigorizitet të respektojnë rregullat e komunikacionit rrugor si : limitet e shpejtësisë, rripin e sigurisë etj.

Neni 6

Asnjë punëtorë nuk mund të ngasë automjetët e KRU "Hidroregjioni jugor" Sh.A pa disponuar me patent shofer valid të lëshuar nga organet kompetentë të Republikës së Kosovës, si dhe të ketë autorizim nga Kompania.

Neni 7

Ne rast udhëtimi jashtë vendi lëshohet autorizim i veçant nga KRU "Hidroregjioni jugor" Sh.A. Prizren dhe i verifikuar në Gjykatën komunale në Prizren, për përdorimin e automjetit zyrtar.

Neni 8

Çdo punëtorë i cili ka nevojë të të përdorë automjetin zyrtar, së pari duhet të plotësoj formularin- kërkesë për përdorimin e automjetit zyrtar (qoftë përkohësishisht ose për një apo disa udhëtime zyrtare) i nënshkruar nga eprori i tij.

Neni 9

Çdo drejtues i automjetit zyrtar është i obliguar që në formularin- fletudhëtimin të shenojë numrin e kilometrave të automjetit në momentin e nisjes, destinacionin e udhëtimit, qëllimin e udhëtimit, emrat e personave që udhëtojnë dhe numrin e kilometrave në momentin e kthimit si dhe nënshkrimin e përdoruesëve.

Neni 10

Drejtuesi i automjetit zyrtar është i obliguar që para pranimit-dorëzimit të automjetit zyrtar të plotësojë formularin e gjendjes së automjetit pasi të këtë kryer kontrollin e automjetit dhe të jetë bindur që ky i fundit është në gjendje të mirë pune, para se ta firmos ai.

Neni 11

Drejtuesi i automjetit është përgjegjës për mirëmbajtjen e tij. Për këtë qëllim çdo drejtues bënë kontrollimin ditor të automjetit:

a) inspektimi ditor paranisjes

- niveli i ujit dhe i ftohjes,
- niveli i vajit për frenim dhe në motor,
- fushat në tabelën e të dhënave posaqërisht matësin e karburantit,
- dritat e përparme, të pasme si dhe treguesit,
- veglat për ndreqjen e defekteve dhe mjetet shtesë,
- burinë,
- tabelën e kilometrave për servisimin e ardhshëm,
- kontrollin e jashtëm (gomat, rrjedhjet e mundshme të vajit, ujit dhe demtimet e tjera etj.).

b) Inspektimi ditor gjatë përdorimit

- sistemin e drejtimit (timonin) dhe frenat.

Drejtuesit janë përgjegjës edhe për sigurinë e automjetit brenda dhe jashtë. Është përgjegjësi e tyre të sigurojnë që automjeti zyrtar të jetë parkuar siç duhet dhe të mos rrezikohet nga vjedhësit, aksidentet, vandalizmi, apo në ndonjë mënyrë tjetër.

Drejtuesi duhet ta raportoj pranë shërbimit të automekanizmit secilin dëmtim të automjetit.

Neni 12

Përgjegjës për servisimin, mirëmbajtje dhe administrimin e automjeteve zyrtare të KRU "Hidroregjioni jugor" është shërbimi i automekanizmit pranë KRU "Hidroregjioni jugor" Sh.A. Prizren.

Neni 13

Shërbimi i automekanizmit pas pranimit të automjetit plotëson një formular ku evidentohen të dhënat e automjetit tipi, nr. i targave, arsyeja e dërgimit të automjetit në servisim dhe defektet. Shërbimi i automekanizmit kujdeset që të mbaj me rregullë dosijen për të gjitha rastet e servisimeve të automjeteve.

Neni 14

Në rast të aksidenteve apo dëmtimesh automjeti nuk dërgohet në servisim pa u bërë kontrolli nga zyrtari kompetent i kompanisë së sigurimeve ku është i siguruar automjeti dhe pa u mbaj procesverbali i shërbimit policor.

Neni 15

Automjetet që shpenzojnë më shumë se që është përcaktuar në dokumentacionin teknik, do të hiqen nga përdorimi dhe do të dërgohen për testim.

Neni 16

Të gjitha kopjet e faturave të furnizimit me karburante, larjen e tyre, pagesat për parkimin e tyre si dhe raportin për përdorimin e automjetit duhet t'i dorëzohet shefit të shërbimit të automekanizmit brenda 15 ditësh nga dita e përdorimit të automjetit.

Shërbimi i automekanizmit harton raportin për shpenzimet mujore të të gjitha automjeteve.

Neni 17

Automjetet zyrtare parkohen dhe çëndrojnë në oborrin e KRU "Hidroregjioni jugor" Sh.A. në Prizren menjëherë pas përfundimit të udhëtimit.

Përgjegjësia

Neni 18

Çdo drejtues i automjetit zyrtar duhet të zbatojë rregullat e përgjithshme të trafikut dhe është përgjegjës për shfrytëzimin e pakujdesshem të automjetit, si dhe përgjigjet për dëmin eventuale të shkaktuar në automjet me fajin e tij.

Neni 19

Shërbimi i automekanizmit do të evidentoj çdo gjë ka të bëjë me automjetin si për shembull gërvishjet, antenën, radion, gomën rezervë si dhe çdo aksesori tjetër të automjetit.

Neni 20

Çdo përdorim i automjetit në kundërshtim me këtë rregullë ndëshkohet sipas përgjegjësisë disiplinore dhe materiale.

Neni 21

Përgjegjës për kontrollin, përdorimin e automjeteve dhe zbatimin e kësaj rregulle është Shërbimi i automekanizmit të KRU "Hidroregjioni jugor" Sh.A. Prizren. Ky shërbim do të ushtroj kontroll ditor edhe periodik mbi automjetet dhe përdorimin e tyre.

Si duhet vepruar në rast aksidenteve

Neni 22

Në rast të përfshirjes së automjetit në ndonjë aksident, drejtuesi i saj duhet të veprojë kështu:

- ndal automjetin dhe qëndron në vendin e ngjarjes deri në arrijtjen e autoriteteve policore ose në kryerjen e të gjitha procedurave të më poshtme, përveq në rast të rrezikut të integritetit të tij.
- Ofron ndihmen e parë personit të lënduar nëse është në gjendje ta bëjë këtë.
- Raporton aksidentin përmes telefonit shërbimin e automekanizmit, gjatë mbrëmjeve apo fundjavës receptionit të kompanisë,
- Në rast të lëndimit të personave të tretë ose pronës drejtuesi duhet patjetër ta lajmëroj policinë vet ose përmes kanaleve të kompanisë.
- Drejtuesi i automjetit i jep policisë ose personit të tretë të gjitha të dhënat e nevojshme në mënyrë të saktë dhe i merr nga personat e tretë të njëjtat po ashtu në mënyrë të saktë.
- Drejtuesi i automjetit zyrtar nuk duhet të marrë asnjë zotim në lidhje me përgjegjësin duke ualënë atë autoritetëve policore,
- Pavarësisht nga serioziteti i aksidentit secili aksident paraqitet në shërbimin e automekanizmit.
- Me rastin e aksidentimit drejtuesi duhet ta mbushë formularin - raport mbi aksidentin dhe ta dorëzojë atë brenda 24 orëve shefit të shërbimit të automekanizmit.
- Këtë raport mund ta bëjë pas kalimit të pengesave nëse drejtuesi i automjetit ka qenë i penguar për këtë gje si pasojë e aksidentit.
- Në rast të vjedhjes së automjetit drejtuesi i saj duhet ta lajmëroj menjherë stacionin më të afërm policor e me pas shërbimin e automekanizmit. Të bëjë raportin mbi vjedhjen e automjetit. Dokumentacioni i kompletuar brenda 72h i dorëzohet kompanisë së sigurimeve.

Neni 23

Kjo Rregullorë do të hyjë në fuqi në datën që shënohet më poshtë.

Prizren, më 01/ 10 / 2010.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve

Mr. sci. Naser Bajraktari

